



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*


---

Nr. 01/141  
Datë: 25.08.2010

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe paragrafit (3) të nenit 4 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 25 gusht 2010, mori

**V E N D I M**

1. Miratohen ekstraktet e procesverbaleve dhe transkriptet nga mbledhjet; 139, 140 të Qeverisë.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

  
Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*


---

Nr. 02/141  
Datë: 25.08.2010

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe paragrafit (3) të nenit 4 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 25 gusht 2010, mori

**V E N D I M**

1. Zotohen mjete financiare në vlerë prej 5,000,000.00 (pesë milionë) euro për projekte kapitale në Mitrovicë.
2. Mjetet financiare nga pika 1. e këtij vendimi sigurohen nga Buxheti i Kosovës dhe projektet do të realizohen në periudhën në vijim, këto mjete transferohen në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal në pajtim me pikën 1. të këtij vendimi sipas dinamikës së pagesave të projekteve.
3. Obligohet Ministra për Ekonomi dhe Financa dhe Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

  
Hashim THACI  
Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*


---

Nr. 03/141  
Datë: 25.08.2010

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe paragrafit (3) të nenit 4 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 25 gusht 2010, mori

**V E N D I M**

1. Miratohet Projektligji për Personat e zhdukur.
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që Projektligjin nga pika 1. e këtij vendimi t'ia procedojë për shqyrtim dhe miratim Kuvendit të Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

  
Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*


---

Nr. 04/141  
Datë: 25.08.2010

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe paragrafit (3) të nenit 4 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 25 gusht 2010, mori

**V E N D I M**

1. Miratohet Projektligji për Këshillin Ekonomiko-Social.
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që Projektligjin nga pika 1. e këtij vendimi t'ia procedojë për shqyrtim dhe miratim Kuvendit të Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

  
Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 05/141  
Datë: 25.08.2010

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe paragrafit (3) të nenit 4 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 25 gusht 2010, mori

**V E N D I M**

1. Miratohet, me vërejtje, Projektligji për Rezervat Shtetërore të Mallrave.
2. Obligohet Zyra për Shërbimet e Ndihmës Juridike për përfshirjen e vërejtjeve në tekstin e Projektligjit nga pika 1. e këtij vendimi.
3. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që Projektligjin nga pika 1. e këtij vendimi t'ia procedojë për shqyrtim dhe miratim Kuvendit të Kosovës.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 06/141

Datë: 25.08.2010

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe paragrafit (3) të nenit 4 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 25 gusht 2010, mori

**V E N D I M**

1. Miratohet Plani për ristrukturimin e Trepçës dhe përgatitjen e saj për tërheqjen e investimeve.
2. Qeveria e Kosovës do ta informojë Kuvendin e Republikës se Kosovës për planet për ristrukturimin e Trepçës dhe përgatitjen e saj për tërheqje të investimeve.
3. Obligohet Ministria për Ekonomi dhe Financa, Ministria e Energjisë dhe Minierave, Agjencia Kosovare e Privatizimit, Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale dhe Ministria e Drejtësisë të përgatisin bazën ligjore të nevojshme për mundësimin e ristrukturimit të Trepçës.
4. Obligohet Ministria e Energjisë dhe Minierave dhe Ministria për Ekonomi dhe Financa të planifikojnë në Buxhetin për vitin 2011 mbështetjen e nevojshme buxhetore për përgatitjen dhe realizmin e procesit të ristrukturimit të Trepçës deri në tërheqjen e investimeve.
5. Obligohet Ministria e Energjisë dhe Minierave dhe Ministria për Ekonomi dhe Financa të kërkojnë edhe financime nga donatorët për këtë qëllim.
6. Me qëllim të zbatimit të Planit për ristrukturimin e Trepçës dhe përgatitjen e saj për tërheqjen e investimeve dhe aktiviteteve të parapara në Plan, themelohet Grupi Ndërinstitucional, i drejtuar nga Ministria e Energjisë dhe Minierave, në përbërje e të cilës do të jenë edhe Ministria për Ekonomi dhe Financa, Agjencia Kosovare e Privatizimit, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale dhe Menaxhmenti i Trepçës.

7. Obligohet Ministria Energjisë dhe Minerave të raportojë progresin në Qeveri çdo tre muaj.
8. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që Planin nga pika 1. e këtij vendimi t'ia përcjellë për njoftim Kuvendit të Republikës së Kosovës.
9. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë
- Agjencisë Kosovare të Privatizimit
- Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale
- Ndërmarrjes Trepça



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 07/141  
Datë: 25.08.2010

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe paragrafit (3) të nenit 4 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 25 gusht 2010, mori

**V E N D I M**

1. Themelohet Komisioni i Përhershëm Qeveritar për kufijtë e Republikës së Kosovës, në këtë përbërje:
  - 1.1. Një përfaqësues, Zyra e Kryeministrit;
  - 1.2. Një përfaqësues, Ministria e Punëve të Jashtme;
  - 1.3. Një përfaqësues, Ministria e Punëve të Brendshme;
  - 1.4. Një përfaqësues, Agjencia Kadastrale e Kosovës;
  - 1.5. Një Ekspert gjeograf, Universiteti i Prishtinës.
2. Komisioni nga pika 1. e këtij vendimi është përgjegjës për të adresuar të gjitha çështjet teknike që ndërlidhen me definimin e demarkacionit të kufijve të Republikës së Kosovës.
3. Komisioni mund të angazhoj ekspert për çështje të caktuara që ndërlidhen me punën e tij.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAJI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 08/141

Datë: 25.08.2010

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe paragrafit (3) të nenit 4 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 25 gusht 2010, mori

**V E N D I M**

1. Ndryshohet dhe Plotësohet Strategjia Legjislative për vitin 2010.
2. Në Strategjinë Legjislative për vitin 2010 shtohet Projektligji për Kadastër.
3. Bartëse për hartimin e Projektligjit për Kadastër, caktohet Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.
4. Obligohet Zyra për Shërbimet të Ndihmës Juridike në Zyrën e Kryeministrit për zbatimin e këtij vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 09/141  
Datë: 25.08.2010

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe paragrafit (3) të nenit 4 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 25 gusht 2010, mori

**V E N D I M**

1. Ndahen mjete financiare në vlerë prej 150,000.00 (njëqindpesëdhjetë mijë) euro ndihmë Republikës Islamike të Pakistanit për përballimin e gjendjes së shkaktuar nga vërshimet.
2. Mjetet financiare nga pika 1. e këtij vendimi ndahen nga rezervat e Qeverisë.
3. Obligohet Ministria për Ekonomi dhe Financa dhe Ministria e Punëve të Jashtme për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 10/141

Datë: 25.08.2010

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenit 309 të Kodit Doganor dhe të Akcizave në Kosovë, si dhe paragrafit (3) të nenit 4 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 25 gusht 2010, mori

**V E N D I M**

1. Z. Naim Huruglica, emërohet Drejtor i Përgjithshëm i Doganave të Kosovës.
2. Mandati i të emëruarit nga pika 1. e këtij vendimi zgjat tre (3) vjet.
3. Obligohet Ministria për Ekonomi dhe Financa për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 11/141  
Datë: 25.08.2010

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe paragrafit (3) të nenit 4 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 25 gusht 2010, mori

**V E N D I M**

1. Institutit Albanologjik të Prishtinës i ndahen mjete financiare në vlerë prej 9,500.00 (nëntëmijepesëqind) euro për mbajtjen e Konferencës Shkencore Ndërkombëtare "Eposi i Kreshnikëve", monument i trashëgimisë kulturore shqiptare, që mbahet nga 28 deri më 30 gusht 2010 në Prishtinë.
2. Mjetet financiare nga pika 1. e këtij vendimi ndahen nga Rezervat e Qeverisë, dhe transferohen në kodin buxhetor të Institutit Albanologjik të Prishtinës.
3. Obligohet Ministria për Ekonomi dhe Financa për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THACI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë